KANTON AARGAU

DEPARTEMENT
BILDUNG, KULTUR UND SPORT
Abteilung Volksschule

Janar 2022

Informacione për kalim prej kopshtit parashkollor (Kindergarten) në shkollën fillore të ulët (Primarschule)

Procedura e propozimit për kalim prej kopshtit parashkollor në shkollën fillore të ulët

Kalimi prej kopshtit parashkollor në shkollën fillore të ulët bëhet në bazë të propozimit nga personeli mësimor i kopshtit parashkollor. Kriteri kryesor për rekomandimin është zhvillimi i mëparshëm i fëmijës në lidhje me kompetencat e përshkruara në kurrikulën Aargau dhe parashikimin për zhvillimin e mëtejshëm të kompetencave. Biseda për kalim dhe propozimi i dhënë mbështetet në dosjen vlerësuese. Aty vë personeli mësimor i kopshtit parashkollor gjatë vitit shkollor shumë punime domethënëse të fëmijut (p.sh. punime individuale, vizatime,fotografitë e artizanatit, vetëvlerësimet e fëmijës etj.). I mbështetur në dokumente në dosjen vlerësuese sqaron dhe e arsyeton personeli mësimor i kopshtit parashkollor te prindërit propozimin për kalim.

Te propozimi për kalim në shkollën fillore të ulët personeli mësimor i kopshtit parashkollor e merr parasysh zhvillimin e fëmijut. Në raste të veçanta mundet kalimi të bëhet në klasën e parë dy vjeçare (Einschulungsklasse) apo një ofertë e përshtatshme për fëmijë apo të rinjë me nevoja të posaçme shkollore.

Procedura (ecuria)

Gjatë vitit të 1 të kopshtit parashkollor mundet personeli mësimor i kopshtit parashkollor me prindërit sipas pyetësorit për vlerësim (Einschätzungsbogen) ta bëjë një bisedë për gjendjen e zhvillimit të fëmijut. Në vitin e dytë të kopshtit parashkollor personeli mësimor është i detyruar që ta zhvilloj një bisedë për kalim në kohën prej shkurti deri në prill ku me dëshirën e prindërve dëgjohet edhe fëmiju.

Personeli mësimor i kopshtit parashkollor dhe prindërit bëjnë marrveshjen me shkrim nëse janë dy palët të pajtimit me propozimin për kalim. Nëse nuk ka marrveshje dhe diferencat nuk mund të kalohen me bisedat në vazhdim (prindër, fëmijë personeli mësimor i kopshtit parashkollor) vendos zyra kompetente e komunës[1] për kalim. Para këtij vendimi prindërit kanë mundësin, që t`i paraqesin argumentet e tyre zyrës kompetente. Procedura e vendimit përfshirë ecurin se si ka ardhë deri te vendimi si edhe mundësin për ankesë ju dërgohet prindërve nga zyra përgjegjëse për vendimin brenda komunës me shkrim. Prindërit kanë mundësin kundër këtij vendimi mbrenda 30 ditësh nga pranimi i këtij vendimi të ankohen te Këshilli Rajonal i Shkollës (Schulrat des Bezirks).

[1] Këshilli i komunës mban përgjegjësinë e përgjithshme për shkollën. Me vendime zyrtare shkollore, si për shembull vendime aftësie, këshilli i komunës mund të ngarkojë një anëtar të këshillit ose drejtorinë e shkollës. Çdo komunë përcakton në një rregullore, çfarë zyre është kompetente për marrjen e vendimeve zyrtare shkollore.